



Datë: 01.08.2025
Numër Protokolli: 5215/2025

A.nr.947/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.947/2025 të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesi S.A kundër organit të punësimit/Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.08.2025 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.947/2025 të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesi S.A.

A r s y e t i m

Ankuesi, S.A(*më tej referuar vetëm* Ankuesi), kandidat për pranim sipas Konkursit me numër Reference RN0016660, të shpallur më datë 10.02.2025 nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Zyrës së Punësimit*” në Pejë, më datë 23.05.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3409/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.947/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndaj zhvillimit të kësaj procedure rekrutimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, *sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, më datë 10.02.2025 ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00016660, për pozitën e Kategorisë së Ulët Drejtuese, “*Udhëheqës i Zyrës së Punësimit*” në Pejë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 11.02.2025 deri më 12.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar nëntëmbëdhjetë (19) kandidatë, ndërsa sipas Njoftimit me numër protokolli 668 të datës 26.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të APRK-së, rezulton se kriteret i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listën e ngushtë vetëm gjashtë (6) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili ka marrë pjesë në vlerësimin e testit me shkrim duke arritur gjithsejtë 31.4 pikë përgjithshme, të pamjaftueshme për të vazhduar tutje me fazën e vlerësimit final atë të intervistës me gojë.

Tutje, sipas Renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 23.04.2025, rezulton se asnjë nga katër kandidatët pjesëmarrës në fazën e testit me shkrim duke përfshirë këtu edhe ankuesin, nuk ka arritur të kalojë prapen e kalueshmërisë prej 50 % të pikëve për të vazhduar tutje me vlerësimin e intervistës me gojë, si rrjedhojë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, më datë 23.04.2025 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 1153, sipas të cilit njoftim rezulton se procedura e rekrutimit me numër reference RN00016660, për pozitën e punës *“Udhëheqës i Zyrës së Punësimit”* në Pejë, ka përfunduar pa fitues, për arsye se asnjë kandidatë nuk ka arritur prapen e kalueshmërisë nga testi me shkrim.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon për shkelje në përmbajtjen e testit me shkrim dhe për përbërje të paligjshme të Komisionit të Vlerësimit, andaj kërkon shqyrtimin e ligjshmërisë së testit me shkrim, verifikimin e Komisionit të Vlerësimit si dhe anulimin e këtij konkursi dhe përsëritjen e tij.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se lartë theksuar se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, përmes Njoftimit me numër protokolli 115 të datës 23.04.2025, ka njoftuar kandidatët për përfundimin e procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00016660, për pozitën e punës *“Udhëheqës i Zyrës së Punësimit”* në Pejë, ngase asnjë kandidatë nuk e ka kaluar prapen e kalueshmërisë prej 50 % të pikëve nga testi me shkrim, dhe se duke pasur parasysh se ankesa e ankuesit është ngritur mbi pretendimet ankimore për shkelje ligjore dhe anulimin, ri shpalljen apo përsëritjen e procedurës së njëjtë të rekrutimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”.***

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundojë procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.947/2025, të datës 29.07.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.947/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.A;
- Udhëheqëses për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.